



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

---

**VENDIM**

**Nr. 13, datë 03.02.2017**

**PËR**

**MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN NR. 129, DATË 26.11.2015**  
**“PËR MARRËDHËNIET E PUNËS SË PUNONJËSVE NË AUTORITETIN E**  
**MBIKËQYRJES FINANCIARE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 12 dhe nenit 20, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

**1. Në nenin 6 të Rregullores nr. 129, datë 26.11.2015 “Për marrëdhëniet e punës të punonjësve në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, pikat 11 dhe 12 ndryshojnë si më poshtë vijon:**

*“11. Komisioni i vlerësimit jep vlerësimin e tij për kandidatët potencialë për punësim duke e shoqëruar me një raport përmbledhës:*

- a) Për pozicionin specialist dhe përgjegjës sektori raporti përmbledhës së bashku me listën e 3 kandidatëve që kanë arritur rezultatet më të larta i paraqitet Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv brenda një afati kohor 5 ditor pune nga përfundimi i vlerësimit;*
- b) Për pozicionin Drejtor Drejtorie dhe Drejtor Departamenti raporti përmbledhës së bashku me listën e 3 kandidatëve që kanë arritur rezultatet më të larta i paraqitet Bordit nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv brenda një afati kohor 5 ditor pune nga përfundimi i vlerësimit.*

12. Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, pasi njihet me raportin e përcaktuar në pikën 11, germa (a), vendos për emërimin e kandidatit ose kandidatëve më të përshtatshëm brenda 3 ditëve pune nga paraqitja e raportit përmbledhës. Bordi, pasi njihet me raportin e përcaktuar në pikën 11, germa (b) miraton kandidatin për pozicionin Drejtor Drejtorie dhe Drejtor Departamenti dhe ia përcjell Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, i cili bën emërimin e kandidatit të përzgjedhur brenda 3 ditëve pune.

**2. Neni 13 i Rregullores nr. 129, datë 26.11.2015 “Për marrëdhëniet e punës të punonjësve në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” ndryshon si më poshtë:**

*“Neni 13*

*Emërimi përfundimtar*

1. Në fund të periudhës së provës, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme/Spektori i Burimeve Njerëzore kërkon një vlerësim me shkrim mbi cilësinë dhe aftësitë individuale në punë, që punonjësi ka demonstruar gjatë periudhës së provës:

- a) Për pozicionin specialist dhe përgjegjës sektori, vlerësimi mbi cilësinë dhe aftësitë individuale në punë, që punonjësi ka demonstruar gjatë periudhës së provës jepet nga Drejtori i Departamentit/Drejtori i Drejtorisë në mungesë të tij Nëndrejtori Ekzekutiv në konsultim me eprorin direkt të punonjësit;
- b) Për pozicionin Drejtor Drejtorie dhe Drejtor Departamenti, vlerësimi mbi cilësinë dhe aftësitë individuale në punë, që punonjësi ka demonstruar gjatë periudhës së provës jepet nga Bordi i Autoritetit.

2. Mbështetur në vlerësimin sipas pikës 1 të këtij neni, Spektori i Burimeve Njerëzore i propozon Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv:

- a) Emërimin përfundimtar si punonjës i Autoritetit;
- b) Zgjidhjen e kontratës së punës dhe largimin nga Autoriteti;
- c) Kalimin e punonjësit në një pozicion më të ulët, në rastet kur punonjësi i nënshtrohet periudhës së provës, si pasojë e emërimit të tij në një pozicion tjetër brenda Autoritetit dhe kur në përfundim të kësaj periudhe opinioni i eprorëve të tij nuk është bindës për konfirmimin e tij në detyrën e re.

3. Vlerësimi me shkrim i Bordit, eprorit direkt dhe drejtorit të departamentit përkatës sipas pikës 1, i komunikohet edhe punonjësit. Ky i fundit, kur nuk është dakord me vlerësimin e eprorëve të tij në përfundim të periudhës së provës, ka të drejtë që brenda 5 ditëve nga komunikimi i vlerësimit, të paraqesë në Sektorin e Burimeve Njerëzore komentet e tij me shkrim.

4. Sektori i Burimeve Njerëzore nëpërmjet Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme kur çmon se nga komentet me shkrim të punonjësit parashtrihen të dhëna që lënë të kuptojnë ekzistencën e një diskriminimi ose paragjykimi mund të vendosë t'i paraqesë Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv propozimin e argumentuar për konfirmimin e punonjësit, duke mos marrë në konsideratë vlerësimin.

**3. Në nenin 32, pikat 3 dhe 4 të Rregullores nr. 129, datë 26.11.2015 “Për marrëdhëniet e punës të punonjësve në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” ndryshojnë si më poshtë:**

*“3. Sektori i Burimeve Njerëzore/Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme përgatit praktikën dhe:*

*a) Në rastin punonjësve në pozicionin Drejtor Drejtorie/Drejtor Departamenti nëpërmjet Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv i paraqet Bordit propozimin e argumentuar për caktimin e një mase konkrete disiplinore, me përjashtim të rastit të tërheqjes së vëmendjes në rrugë verbale;*

*b) Në rastin e punonjësve të tjerë i paraqet Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv propozimin e argumentuar për caktimin e një mase konkrete disiplinore, me përjashtim të rastit të tërheqjes së vëmendjes në rrugë verbale.*

4. Me marrjen dijani të propozimit për caktimin e masës disiplinore ndaj punonjësit, sipas pikës 3 të këtij neni, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv ose Bordi sipas rastit mund të ndërmarrë këto hapa:

*a) Pranimin e propozimit të masës disiplinore;*

*b) Refuzimin e plotë apo të pjesshëm të propozimit për caktimin e masës disiplinore;*

*c) Ngritjen e një komisioni “ad hoc” për rishqyrtimin e propozimit për masë disiplinore.*

**4. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR**

**Pajtim MELANI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**

**Enkeleda SHEHI**